

Datë 31.01.2022

Nr. _____ Prot.

VENDIM

I ORTAKUT TË VETËM

“Për një shtesë në objektin e Shoqërisë”

Sot, më datë 31.01.2022 (dymijë e njëzet e dy), në orën 10:00 në Tiranë, Shqipëri, pranë selisë së shoqërisë “COPERNICUS” sh.p.k., në adresën: Njësia Administrative nr. 7, Rruga “Dritan Hoxha”, pasuria 2/331, ZK.8210, Tiranë, z. Skerdilajd Faria, me datëlindje 21.09.1971, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H10921036C në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë “COPERNICUS” SH.P.K., shoqëri e së drejtës shqiptare, me Nipt M12430004E

Vendos:

1. Miratimin e ndryshimit në Statutin e Shoqërisë, sipas Draftit bashkëlidhur.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË “COPERNICUS” SH.P.K

Z. Skerdilajd Faria

Skerdilajd Faria
Fj



COPERNICUS SH. P. K., - NUIS M12430004E
Rr. "Dritan Hoxha" Nr. 1, pasuria 2/331, ZK.8210, Tiranë, Albania
Mob. +355 67 74 48 550 - e-mail: fatushekruja@gmail.com

**Ndryshime në
STATUT**

COPERNICUS SH.P.K.

Në Statutin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar COPERNICUS SH.P.K., bëhet shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 3 të Statutit, të titulluar “Objekti i Shoqërisë”, pika 3.1 pas gërmës **d)**, shtohet gërma **e)** me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Ofrimin e shërbimeve në fushën e turizmit, shitje/ blerje biletash avioni, traqeti, autobusi dhe/apo të mjeteve të ndryshme të organizimit e formave të udhëtimeve turistike, udhëtime pune etj. Shitje/blerje të paketave turistike, evenimenteve zyrtare dhe jo-zyrtare, organizim konferencash, seminaresh. Udhëtime turistike me grupe të organizuara brenda dhe jashtë vendit. Shitje/ blerje biletash për evente sportive dhe evenimente të ndryshme kulturore dhe artistike. Makina me qira. Siguracion shëndeti në udhëtim. Organizim turesh brenda dhe jashtë vendit. Pushime dhe udhëtime me kroçiera. Shoqëria bashkëpunon me agjenci të tjera turistike, udhëtimi, shoqëri transportesh etj. Vendase dhe/apo të huaja, hotele, resorte, restorante, individë, familje etj., që kanë objekt veprimtarie të njëjtë me të apo që lidhen me objektin e saj të veprimtarisë. Shoqëria do të kryejë aktivitetet në fushën e promovimit të turizmit vendas e të huaj, bashkëpunim me agjenci, persona juridikë, fizikë, individë, institucione të ndryshme shtetërore/publike/private, etj. Shoqëria organizon ture të ndryshme të përmasave të ndryshme në pjesëmarrje, objektiv udhëtimi, qëllime udhëtimi etj., të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me Legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe atë ndërkombëtar. Shitje të produkteve të agjencisë (bileta avioni, bileta autobusi, makina me qira, transfertë, ekskursionet, rezervime apartamentesh dhe hotelesh, udhëtime turistike, bileta eventesh koncerte, sport etj.) online në platformat e rezervimit. Pjesëmarrje në procedura prokurimi publik (tendera) të organizuara nga institucione shtetërore.

